



PROCESVERBAL 12/2024

I Mbajtur në takimin e XII- të të rregulltë të KPF-së me datën **24.12.2024**, në ora **10⁰⁰** në Zyrën e takimeve të Kryetari i Komunës, nën kryesimin e Kryesuesit të KPF-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. Xhavit Zariqi, Kryesues;
2. Arian Imeri, Anëtar
3. Lumnije Morina, Anëtare;
4. Mimoza Pajaziti, Anëtare;
5. Lulzim Abazi, Anëtar;
6. Brahim Osmani, Anëtar;
7. Shqipe Jashari, Anëtare;
8. Hatixhe Bungu Qerimi, Anëtare;
9. Flamur Istrefi, Anëtar.

Drejtorët e drejtorive;

1. Sebahate Ajeti Sadiku - Drejtore e Buxhetit dhe Financave
2. Sabri Murseli – Drejtor i Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Përshëndetje të pranishëm, anëtarë të KPF-së, shoqëria civile, Drejtor të drejtorive, pra po fillojmë me mbledhjen e XII-të të rregullt të KPF-së, besoi që materialin e keni marr me kohë dhe ju dëshiroi mirëseardhje në mbledhjen e KPF-së dhe propozojë këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të KK-së;

4. Propozim – Vendim për Miratimin e Raportit të Komisionit lokal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore;
5. Propozim – Vendim për plotësimin e Listës të pronave të publikuara sipas vendimit me Nr.01.Nr. 105 të datës 31.10.2024 për dhënie në shfrytëzim për Vitin 2025;
6. Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e fushës së Futbollit në Fshatin Teren;
7. Propozim – Vendim për bartjen e pronësisë së pronës së Komunës në emër të Republikës së Kosovës-KOSST-it, ngastrakadastrale me Nr.103 Z.K. Sojevë;
8. Propozim – Vendim paraparak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pjesës së ngastrës kadastrale 1038-0 dhe 1039-0 Z.K. Ferizaj;
9. Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të ngastrave kadastrale; 275-3 Z.K. Gërlicë e Ulët, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 275-2 Z.K. Gërlicë e Ulët, pronë e Komunës së Ferizajt;
10. Pyetje dhe kërkesa dhe
11. Të ndryshme.

Pika shtesë:

1. Propozim – Vendim për Miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2027.

Pika 1

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Fillojmë me pikën e I-rë të rendit të ditës, Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së, të gjithë jemi prezent.

Pika 2

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Miratimi i rendit të ditës, a ka dikush të diskutoi rreth rendit të ditës,

Sebahate Ajeti Sadiku – Faliminderit kryesues, sot e kemi sjellë një propozim si pikë shtesë, ku është e parapamë që të bëhet miratimi i Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2027, ky planifikim është përgatitur me bashkëpunim me mbështetjen e UN Women Kosovë në kuadër të zbatimit të projektit “Gender Equality Facility” (GEF) me fonde të Bashkimit Evropian, qëllimi që ju kemi sjellë këtë propozim është që brenda Vitit 2024 të aprovohet, megjithatë e kemi sjellë me vonesë, por deri sa e kemi sjellë për mbledhje jemi dakorduar për planifikimin buxhetor me ekipën ndimëse ndaj you women, dhe për këtë arsye po ju propozoi që të kaloj për kuvend, i ka kaluar të gjitha procedurat të dëgjimi publik edhe procedurat të tjera ligjore që janë kërkuar, sot është si lëndë përfundimtare.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Faleminderit Drejtoresh, dikush tjetër?

Sabri Murseli – Faliminderit kryesues, te pika e 7-të është Propozim – Vendim për bartjen e pronësisë së pronës së Komunës në emër të Republikës së Kosovës-KOSST-it, ngastra kadastrale me Nr.103 Z.K. Sojevë, gabimisht e kanë shkru dhe këtu është sjellë drafti gabimisht dhe materialin kur e kam prurë e kam korrigju propozimin dhe se propozimi është i sakt në dosje,

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Dikush tjetër?

Sabri Murseli - Kryesues te lista e pronave një parcel.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Kush është që të kaloj në kuvend rendi i ditës i ndryshuar nga pika e 7-të, Propozim – Vendim për bartjen e pronësisë së pronës së Komunës në emër të Republikës së Kosovës-KOSST-it, ngastra kadastrale me Nr.103 Z.K. Sojevë?, faleminderit, 8-të vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon.

Vazhdojmë edhe me pikën shtesë nga Drejtoresha e financave, Propozim – Vendim për Miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2027, kush është që të kaloj kjo pikë?, faleminderit, 8-të vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon.

Sebahate Ajeti Sadiku – Kryesues, materialin jua dorëzova tash, besoi që intergrafi na i sjell kopjet me ju shpërnda, por nuk kam shka me shtu, kjo i ka kalu krejt procedurat dhe se nuk kemi shtu kurgja, vetëm se në Vitin 2024, 2025, 2026 nuk kemi cek shuma buxhetore me të vetmin qëllim, me falni nuk ma pasni dhanë fjalën.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Jo, vazhdojmë me pikën e III-të të rendit të ditës.

Pika 3

Kryesuesii KPF-së Xhavit Zariqi – Vazhdojmë me Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të KPF-së; a ka dikush ndonjë vërejtje rreth procesverbalit të mbledhjes së kaluar, si duket jo, a jeni që të kaloj procesverbali i mbledhjes së kaluar?, faleminderit, 8 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e X-të të rendit të ditës.

Pika 10

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Drejtoresh e ki fjalën për Propozim – Vendimin për Miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2027.

Sebahate Ajeti Sadiku – Kryesues i vetmi ndryshim është në materialin përfundimtar, është influence buxhetore, për Vitin 2025, 2026 dhe 2027, sepse i kena marr për bazë investimet që i kena parapar në buxhet për këtë vit, në aplikimin e barazisë gjinore dhe faktikisht janë të njejtat, kanë ndikuar në vitin e ardhëshëm dhe se simbas rritjes buxhetore do të ketë rritje edhe për këtë plan, për këtë arsye edhe jena vanu për procedim e sipër, por megjithatë edhe ne seancën e fundit të jetë i aprovum dhe t'i kalojmë procedurat dhe të vazhdojmë më tutje.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Faliminderit, a ka dikush tjetër të diskutojë?, mbasi nuk ka, kush është që të kaloi në kuvend pika e X-të, faleminderit, 8 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e IV-të të rendit të ditës.

Pika 4

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për Miratimin e Raportit të Komisionit lokal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore, kush është i interesum të diskutoi për këtë pikë?

Arian Imeri – Te vlerësimi i dëmeve, është bërë vlerësimi i cili nuk parashihet me ligj, në herën e kaluar e kam kërkuar për me e lagu këtë propozim, e tash po e shohë që është në rregullë për me kalu për kuvend.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Sa i përket kësaj pike, a e kalojmë për kuvend?, Propozim – Vendimin për Miratimin e Raportit të Komisionit lokal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore; faleminderit, 8 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e V-të të rendit të ditës.

Pika 5

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Propozim – Vendim për plotësimin e Listës të pronave të publikuara sipas vendimit me Nr.01.Nr. 105 të datës 31.10.2024 për dhënien në shfrytëzim për Vitin 2025, urdhëro drejtor!

Sabri Murseli – Faleminderit kryesues, përshëndetje anëtarë të komitetit, Propozim - Vendimi për Listën e pronave të publikuara sipas Vendimit me Nr.01.Nr. 105 të datës 31.10.2024 për dhënien në shfrytëzim për Vitin 2025 që është miratuar para dy muajve, plotësohet edhe me 6 njësi kadasrale parcela 23 asi objekti 3 te kompleksi Talinovc i muhaxhirëve të ish kooperativat, që nuk ka mundësi që në të ardhmen me shëndru diçka në atë zonë, parcela me Nr. 400-0 Lloshkobare, 399-0 Lloshkobare, 349-0 Mirosalë, 550-0 Mirosalë dhe plotësohet me parcelën 2049-1 Z.K. Ferizaj, është një pjesë e parcelës së vogël që plotëson lista, ndërsa nga lista duhet të hiqet Çerdhja “Te Engjujt” që është te “Apolonia” sepse është e nënshkruar me KARITAS-in dhe në tri vite në të ardhmen nuk mundet të ipet për shfrytëzim, që është e parapame për fëmijët, që është marrëveshje me KARITAS-in dhe për tri vite të ardhshme nuk mund të ketë ndryshime, me këto ndryshime, është lista finale me për Vitin 2025.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Faleminderit, a dëshiron të diskutojë dikush tjetër për këtë pikë?, a jeni që të kaloi në kuvend?, kush është që të kaloi pika e V-të?, faleminderit, 8 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e VI-të të rendit të ditës.

Pika 6

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e fushës së Futbollit në Fshatin Teren, urdhëro drejtor!

Sabri Murseli – Kryesues, ky Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e fushës së Futbollit në Fshatin Teren, kjo kërkesë është e komunitetit dhe komplet do të financohet prej komunitetit të fshatit, hapësira është afër fushës ekzistuese, a e financojnë mirë, a nuk e financojnë, prona do të jetë prapë e komunës.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Faleminderit, a dëshiron të diskutojë dikush tjetër për këtë pikë?, a jeni që të kaloi në kuvend?, kush është që të kaloi pika e VI-të?, faliminderit, 8 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e VII-të të rendit të ditës.

Pika 7

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për bartjen e pronësisë së pronës së Komunës në emër të Republikës së Kosovës-KOSST-it, ngastra kadastrale me Nr.103 Z.K. Sojevë, urdhëro drejtor!

Sabri Murseli – Kryesues, kjo pikë në material është në rregullë, ky Propozim – Vendim ka të bëjë për bartjen e pronësisë së pronës së Komunës në emër të Republikës së Kosovës-KOSST-it, ngastra kadastrale me Nr.103 Z.K. Sojevë, që ka ardhur prej Ministrisë së ekonomisë, ministria e ka bartjen në pronësi të Republikës së Kosovës - Kompanise publike Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu SH.A. (KOSST projekt me SHBA-an, kryesisht prej DSS-së, të cilën e jep Qeveria me SHBA-an, kryesisht ka për ruajtjen e energjisë, financuar prej Shtetit të Kosovës në bashkëpunim me SHBA-në, në bazë të marrëveshjes me Organizatën "Compact", e cila simbas komunitetit është bazuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës përmes Ligjit Nr. 08/L-159, e cila në aspektin ligjor bartet direkt prej qeverisë me bashkëpunim me SHBA-në, për ruajtje të energjisë me këto bateria.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Faliminderit drejtor, a dëshiron dikush të diskutoi për këtë pikë?, a jeni që të kaloi në kuvend?, kush është që të kaloi pika e VII-të?, faliminderit, 8 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e VIII-të të rendit të ditës.

Pika 8

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim paraparak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pjesës së ngastrës kadastrale 1038-0 dhe 1039-0 Z.K. Ferizaj, urdhëro drejtor!

Sabri Murseli – Faleminderit kryesues, ky Propozim – Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pjesës së ngastrës kadastrale 1038-0 dhe 1039-0 Z.K. Ferizaj ka të bëjë për tregun e gjelbërt për dhënie në shfrytëzim afatgjatë prej 40 viteve, çmimi është formal 100€, për shkak të vlerës së investimit që do të bëhet të tregut të gjelbërtë, e cila do të bëhet një analizë prej Drejtorisë së urbanizmit, e cila është e bashkangjitur në material, është analizë ekonomike dhe financiare të tregut të gjelbërt, e cila paraqet të gjitha fazat të cilat do të investohen, për më tepër është paraparë edhe garancioni bankar, i cili në rast se nuk implementohet, mund të ekzekutohet direkt nga komuna, kështu që është pikë që mundet me u diskutu, varësisht nga propozimet që dalin nga dokumentet, kështu që nuk mundemi me financu vet, nëse është e dobishme mirë, e nëse jo mundet me u anulë.

Arian Imeri – Drejtor a është ky propozim në kushte të ankandit,

Sabri Murseli – Po në kushte të ankandit ja ku e ki fleta e dytë, ku thotë: Kriteret e konkursit publik për shprehje të interesit për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale janë përcaktuar saktësisht në nenin 20 të Rregullores (Qrk) Nr. 0912020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, numri i investimeve i mbështetjes së interesit, ku thotë në shfrytëzim të pronës, ky është propozim paraprak, te kriteret është direkt, vlera e investimeve, numri i llojit të investimit, përfitimi i vlerës së komunës dhe kriteret tjera të cekura në konkurs, Garancionin-Polisën e sigurimit në lartësi të vlerës së investimit, e cila duhet të jetë në kohëzgjatje të planit dinamik të investimeve në projekt të propozuara në ofertë, pra nëse plani në propozim është 10 vite, 10 vite duhet me pas garancion me vlerë të investimeve, kështu që është epitë që e mbronë institucionin dhe ka mundësi nëse ka vështërsi na e kthejna garancionin dhe e kthejna vet projektin, në qatë shumë që e inkasojna projektin prej përfituesit në këtë rast.

Flamuri Istrefi – Drejtor në emër të kujt ka qenë projekti?

Sabri Murseli – Investim të ambientit, tash ambienti e ka nënkontrakt për inkasim një kompani tjetër, e që ka qenë edhe raportim i auditorit, mirëpo rasti i ”Stacionit të autobusëve”, prona bartet në aspektin juridik, atëherë raporti komplet në komitet për këmbimin e pronës, ata kanë marr një vendim paraprak për me anulë aderimin.

Flamuri Istrefi – Të hyrat kush i ka marr, “Ambienti”?

Sabri Murseli – Po “Ambienti”.

Flamuri Istrefi - Çdo vjet i kena minus 320.000€ , d.m.th. është minus, nuk ka të hyra vjetore në bazë të planit që e keni paraqit këtu, i bie me projektin e ri 320.000€ kush do që e merr projektin përpos të hyrave që e keni ba.

Arian Imeri - 3200.000€ nuk i merr sot.

Flamuri Istrefi – Është afatgjate, nuk e ka një kompani komunale të cilën me 320.000 të hyra vjetore, nuk po kuptoi dhe kështu thotë edhe parking nëntokësor, tash është ndrim destinimi.

Sabri Murseli – Me PZHK është parking nëntokësor tre.

Flamuri Istrefi – Veç parking nëntokësor, pse me shkru 3,

Sabri Murseli – Ka diçka tjetër, informatat Flamur ja kam bashkangjitur, parking nëntokësor dhe tregu, në bazë të ekspeditivit, parkingu do të jetë poshtë, e tregu do të jetë mbi parking,

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – A ka tjerë të interesum për diskutim, a jeni që të kaloi në kuvend pika e VIII-të e rendit të ditës?, faleminderit, 6 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon edhe fillojmë me pikën e IX-të të rendit të ditës.

Pika 9

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të ngastrave kadastrale; 275-3 Z.K. Gërlisë e Ulët, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 275-2 Z.K. Gërlisë e Ulët, pronë e Komunës së Ferizajt, urdhëro drejtor!

Sabri Murseli – Kryesues ky Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të ngastrave kadastrale; 275-3 Z.K. Gërlisë e Ulët, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 275-2 Z.K. Gërlisë e Ulët, pronë e Komunës së Ferizajt, kjo pjesë e magjistrale është marr prej një personi, mirret kjo pjesa që është me kyqje, mirret pjesa anësore, d.m.th. kjo këndeje ipet, d.m.th ipet kjo pjesa e rrugës , kyqja në aspektin juridik është gjithshka në rregullë, faleminderit,

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Faleminderit drejtor, a ka të interesum për diskutim?, a jeni që kjo pikë e rendit të ditës të kaloi në kuvend, faleminderit, 8 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon edhe fillojmë me pikën e XI- të rendit të ditës në të ndryshme, mbasi pikën e X-të e diskutuam më herët.

Pika 11

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Të ndryshme, a ka dikush të diskutoi për këtë pikë, nuk ka, atëherë me kaq po e mbyllim mbledhjen e KPF-së, faleminderit për pjesëmarrje.

Procesmbajtësja



Zyliha Tafarshiku

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi